



PULLE TARIFE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT SHKODËR

Nr. 59/2015 (3117)

Datë 06.11.2015

Nr.Vendimi 29

Datë 26.04.2016

VENDIM

“ Në Emër të Republikës ”

Gjykata e Apelit Shkodër e përbërë nga gjyqtarët:

Lindita HOXHA – Kryesuese

Astrit KALAJA - Anëtar

Valbona VATA -Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore Aida Okaj, sot me datë 26.04.2016 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen adm/civile që i përket palëve:

KËRKUES: “Ar Europrojects“ shpk, adresa Rr.”13 Dhjetori”, pranë Dhomës së Tregtisë e Industrisë Shkodër, administrator Bruno Lauri, përfaqësuar në gjykim nga av.Artan Reçi, sipas prokurës së posaçme nr.390 rep, nr. 158 kol., datë 07.03.2016.

PALA E TRETË: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, përfaqësuar në gjykim nga juristja Sirjana Bakushi sipas autorizimit nr.972 prot, datë 26.01.2016.

PALA E INTERESUAR: Shpresa Breçani, administratore e falimentit të “Ar Europrojects“ shpk, jo e pranishme në seancë gjyqësore, gjykuar në mungesë.

OBJEKTI: Rivendosje në afat për kundërshtimin e vendimit civil nr.235(612), datë 12.02.2015 të Gjykatës Civile të Rrethit Gjyqësor Shkodër.

BAZA LIGJORE: Neni 458 i K.Pr.Civile.

Me vendimin nr.59(3117), datë 20.07.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur:

-Pushimin e çështjes.

-Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

-Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Shkodër.

-Ky vendim t’u njoftohet palëve në mungesë.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim pala kërkuese e cila parashtrohet këto shkaqe:

- 1-Vendimi nr.59(3117), datë 20.07.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është një vendim i paligjshëm dhe i papastër që ka shkak për anulim, të cilat janë të detyrueshme për tu zbatuar nga gjykata.
- 2-Gjykata nuk ka thirrur në gjyq as kërkuesin "Ar Europrojects" shpk, as përfaqësuesin e tij Bruno Lauri, edhe e ka zhvilluar gjykimin në mungesë të tyre. Gjykata ka gabuar në zbatimin e nenit 179 të K.Pr.Civile, pasi siç e ka konstatuar vetë, ekziston një shkak i arsyeshëm.
- 3-Avokati Ylli Kameri përfaqësues e ka kërkuar shtyerjen e seancës vetëm për shkaqe të ligjshme edhe në zbatim të drejtë të nenit 175, gjykata duhej të shtynte gjykimin për një ditë tjetër. Rezulton nga prokura se ai nuk kishte tagër që të caktonte një avokat tjetër zëvendësues. Në kërkesën e shtyerjes së seancës, avokati ka kërkuar: *"Lutem të shtyni seancën për me datën 16.07.2015 në orën 15.00 duke premtuar se do të paraqitem në këtë orar"*. Avokati është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër në orën 15.00 edhe jashtëgjyqësisht ka marrë vesh se gjykata do të zhvillonte një seancë gjyqësore me datën 20 Korrik 2015, por nuk është komunikuar ora e saktë. Gjykata në kundërshtim me nenin 174 nuk ka verifikuar nëse avokati kishte dijeni edhe për orën e caktuar, pasi në kërkesën e tij për shtyerje, ai argumenton se nuk mund të paraqitet në një seancë pa orë të saktë, pa njoftim nga gjykata edhe aq më tepër kur kishte për të përfaqësuar interesa të ligjshme të një klienti që vuan dënimin në burgjet famëkeqe Greke. Në këto rrethana, Gjykata e Apelit të konstatojë se në kushtet e pasigurisë së orareve, avokati nuk është paraqitur për shkakun e arsyeshëm se nuk kishte dijeni për orën e caktuar, edhe pasi për shkaqe të ligjshme duhet të plotësonte me dokumente mbrojtjen e një shtetasi të dënuar penalisht.
- 4-Gjykata nuk ka bërë njoftimin as në telefon.
- 5-Gjykata ka zbatuar gabim nenin 179, pasi nuk ka argumentuar edhe ka lënë pa zbatuar nenin 175 të K.Pr.Civile, ku përcaktohet saktë se "Në rast se mosparaqitja ka ndodhur për shkak tjetër të ligjshëm gjykata e shtyn gjykimin për një ditë tjetër".
- 6-Po kështu nga kontaktet me administratoren e falimentit edhe nga dosja gjyqësore rezulton se gjykata as që ka kryer veprimet procedurale për të lajmëruar të gjitha palët në gjykim, pasi administratorja e falimentit prezenca e së cilës u bë shkak për shtyerjen e seancës nuk ka marrë dijeni. Për këtë arsye mendoj se veprimi i gjykatës për pushimin e gjykimit, ka ardhur si rrjedhojë krijimit të mundësive për të mos i dhënë zgjidhje çështjes.
- 7-Bazuar në praktikën e Gjykatës së Lartë edhe Kushtetuese, vendimet e gjykatës për të pushuar çështjen kur ka mbaruar procesi i marrjes së të gjitha provave si dhe për shkakun se vetë datat e gjykimit janë lënë pa hapësira përgatitore, për vetë faktin se selia e avokatit ndodhet në Tiranë, ka pasjellë pamundësinë edhe mungesën e aksesit nëpërmjet pjesëmarrjes në gjykim të palës kërkuese.
- 8-Gjykata e Apelit duhet të marrë në konsideratë se nga data e paraqitjes së kërkesës për rivendosje në afat, kam udhëtuar nga Tirana në Shkodër, për 8

seanca rresht duke treguar interesim të ligjshëm edhe të vërtetë për të marrë një vendim ligjor për kërkimin e bërë, edhe gjykata nuk e mbështet në prova faktin që “po pengoj zhvillimin e procesit në afat”.

9-Pushimi i çështjes është një vendim tërësisht i padrejtë edhe rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor.

Kundër ankimit të palës kërkuese ka paraqitur kundër-ankim pala e tretë Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër e cila parashtron këtë arsyetim:

1-E mbështesim vendimin nr.59(3117), datë 20.07.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, pasi është një vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj.

2-Në seancën gjyqësore të datës 20.07.2015 pala kërkuese, Shoqëria “Ar Europrojects” shpk, jo hera e vetme, nuk u paraqit në gjykim, ndonëse rezultonte të kishte dijeni për datën dhe orën e seancës. Sipas gjykatës mësojmë se, kërkohet edhe këtë herë shtyerje e gjykimit nga avokati i palës.

3-Pala ankuese nuk legjitimohet në paraqitjen e ankimit ashtu sikurse nuk legjitimohej dhe në adresimin, bërjen prezent të kërkesës për “rivendosja në afat për kundërshtimin e vendimit civil nr.235(612) i datës 12.02.2015 të Gjykatës Civile të Rrethit Gjyqësor Shkodër”, para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

4-Në lidhje me Shoqërinë janë hapur procedurat e falimentit dhe është caktuar me vendim të Gjykatës administratorja përkatëse e falimentit. Bëjmë të ditur se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është zhvilluar gjykimi i çështjes gjyqësore civile me palë kërkuese *Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër*, person i tretë, *Shoqëria “Ar Europrojects” shpk* dhe me objekt gjykimi “kërkesë për faliment”. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.235(612), datë 12.02.2015 ka vendosur pranimin e kërkesës. Në këtë vendim gjykata shpreh: Kërkues *Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër* përfaqësuar nga..., person i tretë, *Shoqëria “Ar Europrojects” shpk* përfaqësuar nga Ervis Myftari, gjithashtu në vendimin e saj shpreh: “Gjykata pasi administroi provat shkresore, dëgjoi pretendimet e kërkuetit *Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër* dhe personit të tretë, “Ar Europrojects” shpk që kërkuan pranimin e kërkesës....”. Pra nuk qëndron pretendimi i subjektit në kërkesën e tij, se ka qenë në mungesë në shpalljen e vendimit. Ky vendim është marrë në prezencë të palëve dhe është një vendim që ka marrë formë të prerë.

5-Komunikimet nga gjykata janë bërë mbi bazën e adresës së deklaruar nga vetë subjekti referuar dhe të dhënave të ekstraktit të rregjistrimit të subjektit në QKR. Gjykimi i kësaj çështje është tejzgjatur si pasojë e njoftimeve të vazhdueshme të bëra nga gjykata në adresën e subjektit, por që herë paraqitej një përfaqësues i tij, herë jo. Pra nuk qëndron pretendimi i subjektit se nuk është njoftuar për zhvillimin e seancave gjyqësore apo aktet në gjykim.

6-Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr.235(612), datë 12.02.2015 është shpallur në prezencën e përfaqësuesve të palëve sipas akteve përkatëse të përfaqësimit depozituar para trupit gjykues dhe shprehur nga gjykata në vendimin e saj, prandaj dhe Shoqëria “Ar Europrojects” shpk nëse nuk do të ishte dakort me këtë vendim mund ta ankimonte duke respektuar

afatet përkatëse ligjore, megjithëse përfaqësuesi i legjitimuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për Shoqërinë "Ar Europrojects" shpk dhe në seancën e shpalljes së vendimit që vendosi "për pranimin e kërkesës për kalimin e subjektit për faliment" u shpreh se ishte dakort për kalimin e subjektit për faliment. Prezent në këtë vendimmarrje ishte dhe administratorja e falimentit.

Gjykata e Apelit Shkodër, pasi dëgjoi relatoren e çështjes gjyqtaren Lindita Hoxha, dëgjoi përfaqësuesin e palës kërkuese i cili kërkoi prishjen e vendimit dhe kthimin e gjykimit të çështjes me tjetër trup gjykues, përfaqësuesen e palës së tretë e cila kërkoi lënien në fuqi të vendimit, në mungesë të palës së interesuar dhe si e shqyrtoi në tërësi çështjen

VEREN

Vendimi nr.59(3117), datë 20.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është një vendim i drejtë, i bazuar në ligj e në prova dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Nga aktet e administruara ka rezultuar se: Kërkuesi shoqëria Ar-Europrojekt sh.p.k, ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër rivendosjen në afat për kundërshtimin e vendimit civil nr.235(612) i datës 12.02.2015 të Gjykatës Civile të Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Në lidhje me shoqërinë janë hapur procedurat e falimentit dhe është caktuar me vendim të Gjykatës administratorja përkatëse e falimentit që është Shpresa Breçani. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është zhvilluar gjykimi i çështjes gjyqësore civile me palë kërkuese *Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër*, person i tretë, *Shoqëria "Ar Europrojects" shpk* dhe me objekt gjykimi "kërkesë për faliment". Në lidhje me këtë çështje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.235(612), datë 12.02.2015 ka vendosur pranimin e kërkesës. Ky vendim është marrë në prezencë të palëve dhe është një vendim që ka marrë formë të prerë.

Me arsyetimin se nuk ka patur dijeni për vendimin, kërkuesi shoqëria Ar-Europrojekt ka kërkuar rivendosjen në afat të të drejtës së ankimit ndaj vendimit nr. 235(612), datë 12.02.2015 të Gjykatës Civile të Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin objekt ankimi ka filluar shqyrtimin e kërkesës duke caktuar datën e seancës gjyqësore me datë 02.06.2015. Në këtë seancë gjyqësore nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës kërkuese, avokat Ylli Kamëri, i cili ka bërë dijeni por nuk është paraqitur duke kërkuar me shkrim shtyrjen e seancës gjyqësore, meqënëse ndodhej në një gjykim tjetër pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Seanca e radhës është caktuar me datë 09.06.2015. Në këtë seancë përgatitore janë paraqitur palët dhe gjykata pasi ka zhvilluar seancën përgatitore, ka vendosur të kalojë çështjen në seancë gjyqësore me datë 24.06.2015. Në këtë seancë gjyqësore palët kanë qënë të pranishme dhe seanca është shtyrë me kërkesë të palës së tretë, përfaqësueses së

D.R.T Shkodër e cila ka kërkuar që të thirret në këtë gjykim si palë edhe administratorja e shoqërisë e caktuar si likuidatore. Pasi ka zhvilluar edhe dy seanca gjyqësore në datat 02.07.2015 dhe 16.07.2015, Gjykata në seancën e tretë të datës 20.07.2015 ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes për mosparaqitje pa shkak të arsyeshem të përfaqësuesit të kërkuarit, avokatit Ylli Kameri.

Në këtë seancë gjyqësore është paraqitur vetëm përfaqësuesja e palës së tretë, DRT Shkodër, dhe gjykata i ka bërë me dije kësaj palë kërkesën e përfaqësuesit të shoqërisë Ar-Europrojekt sh.p.k për shtyrjen e seancës gjyqësore. Në kërkesën e tij për shtyrje të seancës gjyqësore, përfaqësuesi ka paraqitur si shkak të mosparaqitjes së tij në gjykim angazhimi si avokat mbrojtës i shtetasit Dritan Çela dhe në realizimin e mbrojtjes së tij, avokatit i duhet që të udhëtojë drejt shtetit Grek. Bashkëlidhur kërkesës për shtyrje, avokat Ylli Kameri ka paraqitur edhe një kopje të aktit të përfaqësimit, lëshuar në Tiranë në muajin shtator 2009, miratuar nga autoriteti i burgut Grek. Ky akt përfaqësimi nuk mund të ketë vlerën e provës justifikuese për përfaqësuesin e palës kërkuar, pasi është një akt fotokopje, i panjehsuar me origjinalin, mban një vit të hershëm 2009 dhe nuk provon se në kohën kur është zhvilluar seanca, avokati ka qënë në mbrojtje të interesave të këtij shtetasi në organet e ndjekjes penale në shtetin Grek.

Në këto rrethana, drejt ka vepruar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e cila ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, duke e konsideruar të pajustificuar mosprezencën e përfaqësuesit të palës kërkuar në Gjykatë, në seancën e datës 20.07.2015.

Pretendimet e parashtuara në ankim nga pala kërkuar, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, nuk gjenden të bazuar në prova dhe si të tilla nuk e cënojnë vendimin e gjykatës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata e Apelit Shkodër bazuar në nenin 466/a të Kodit të Procedurës Civile

VENDOSI

Lënien në fuqi të vendimit nr. 59 (3117), datë 20.07.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Shkodër datë 26.04.2016

Anëtare
Valbona VATA
d.v

Anëtar
Astrit KALAJA
d.v

Kryesuese
Lindita HOXHA
d.v

Vërtetohet njësia me origjinalin
KANCELARE
Greta Margjokaj (Laloshi)